

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pml.-Kzz. Nr. 150/2015

1 shtator 2015

Prishtinë

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova, kryetare e kolegjit , Gjyqtari i EULEX-it Dariusz Sielicki dhe Gjyqtarja e Gjykatës Supreme Emine Mustafa si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga Zyrtari ligjor i EULEX-it Holger Engelmann si procesmbajtës, në lëndën penale kundër:

1. **B. D.**, mashkull, emri i babait S., i lindur më ... në fshatin XXX, komuna e Gllgocit, shqiptar i Kosovës , me vendbanim në rrugën XXX, Kosovë;
2. **H. T.**, mashkull, emri i babait B., i lindur më 10 maj 1976 në fshatin XXX, komuna e Skenderajt, shqiptar i Kosovës , me vendbanim në rrugën XXX, Kosovë;

Të dytë të akuzuar me aktakuzën PPS. 45/2012, të datës 19 maj 2014, e paraqitur pranë shkrimores së Gjykatës Themelore në Prishtinë më 21 maj 2014, për veprën penale:

Ushtrim i ndikimit, duke kërkuar, marr ose pranuar një ofertë ose premtim të një përparësie të padrejtë për vete ose për personin tjetër në lidhje me ushtrimin e një ndikimi të pa duhur nga ana e kryerësit mbi vendimmarrjen e një personi zyrtar, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ushtrimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar, në shkelje të nenit 345 paragrafit 1 të Kodit Penal të Kosovës¹ (tani e tutje KPK);

I gjykuar në shkallë të parë nga Gjykata Themelore në Prishtinë me aktgjykimin P.Kr. Nr. 282/14, të datës 4 shkurt 2015, me të cilin të pandehurit B. D. dhe H. T. janë shpallur fajtorë, secili prej tyre është dënuar me një (1) vit e tre (3) muaj burgim dhe që të dytë janë urdhëruar që së bashku ta paguajnë shumën prej 200,000 Euro si kompensim;

I ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR 157/15 të datës 28 maj 2015, me të cilin Gjykata e Apelit ka gjetur se parashkrimi kishte skaduar dhe si të tillë e kishte refuzuar aktakuzën PPS nr. 45/2012, të datës 19 maj 2015, të paraqitur kundër të pandehurve B. D. dhe H. T. më 21 maj 2014;

Duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur më 24 qershor 2015 nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZPShK) kundër aktgjykimit PAKR. Nr. 157/2015 të Gjykatës së Apelit të datës 28 maj 2015,

Pas këshillimit dhe votimit më 1 shtator 2015,
Lëshon këtë :

¹ I lëshuar si 'Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës , i nxjerrë si Rregullore e UNMIK-ut 2003/25, e datës 6 korrik 2003, e riemëruar me Ligjin nr. 03/L-002, në fuqi deri më 31 dhjetor 2012

AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur më 24 qershor 2015 nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit kundër aktgjykimit PAKR. Nr. 157/2015 të Gjykatës së Apelit të datës 28 maj 2015, PRANOHET SI E BAZUAR në dëm të të pandehurve. Gjykata Supreme e Kosovës PËRCAKTON SE me aktgjykimin e kundërshtuar ËSHTË SHKELUR LIGJI në dobi të të pandehurve.

ARSYETIM

1. Historia e Procedurës

Më 1 gusht 2011, Prokuroria Speciale e Kosovës (tani e tutje PSRK), Prokurori Ali Rexha ka lëshuar aktvendimin mbi fillimin e hetimeve kundër pesë (5) të pandehurve të dyshuar për kryerjen e veprave penale Krim i organizuar, Pastrim i parave , Dhënie e ryshfetit dhe Marrje e ryshfetit. Më 31 janar 2012, Gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë ka vazhduar hetimet për këto akuza edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë deri më 1 gusht 2012, nën lëndën me numër PPS 48/2011.

Më 21 maj 2012, Prokurori i PSRK-së Ali Rexha a lëshuar aktvendimin mbi fillimin e hetimit në lidhje me shtatë të pandehur të tjerë, përfshirë dy të pandehurit në fjalë B. D.N dhe H. T.N, të dyshuar për kryerjen e veprave penale Marrje e ryshfetit, Dhënie e ryshfetit, Ushtrim i ndikimit dhe Keqpërdorim i pozitës apo i autoritetit zyrtar.

Më 23 maj 2012, Prokurori i PSRK-së ka lëshuar aktvendimin mbi konsolidimin e të dy rasteve nën numrin PPS 45/12, dhe më 18 dhjetor 2012, gjyqtari i procedurës paraprake ka vazhduar hetimet deri më 21 maj 2013.

Më 4 prill 2013, Prokurori i PSRK-së i EULEX-it Andrew Carney ka lëshuar aktvendimin mbi zgjerimin e akuzave për hetim kundër të pandehurve, dhe më tutje më 20 maj 2013 ka lëshuar aktvendimin e mëtutjeshëm mbi zgjerimin e hetimeve në lidhje me akuzat për armë kundër pesë (5) të pandehurve.

Më 16 korrik 2013, Prokurori i PSRK-së i EULEX-it ka paraqitur kërkesën për vazhdimin e hetimeve të konsoliduara dhe të zgjeruara.

Më 26 prill 2013 dhe 11 shkurt 2014, hetimet janë ndërprerë kundër një numri të pandehurve, dhe me aktvendimin e fundit, kundër të pandehurit H. T. lidhur me akuzat për armë.

Më 21 maj 2014, Prokurori i PSRK-së Andrew Carney ka ngritur aktakuzë në lëndën PKr 282/14 kundër dy të pandehurve në fjalë, të datës 19 maj 2014.

Pas njëmbëdhjetë (11) seancave, Gjykata Themelore e Prishtinës ka lëshuar aktgjykimin P.-Kr. Nr. 282/14, të datës 4 shkurt 2015, me të cilin të pandehurit B. D. dhe H. T. janë shpallur fajtorë dhe që të dy janë dënuar me nga një vit e tre muaj burgim si dhe janë urdhëruar që së bashku të paguajnë shumën prej EUR 200,000, dhe gjithashtu janë urdhëruar që secili prej tyre ta rimburojë shumën prej 150 Euro si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale dhe janë liruar nga pagesa e pjesës tjetër të shpenzimeve.

Avokati mbrojtës Mahmut Halimi në emër të pandehurit B. D., avokati mbrojtës Bajram Tmava në emër të pandehurit H. T., i pandehuri H. T. dhe Prokuroria kanë paraqitur ankesa kundër aktgjykimit P.-Kr. nr. 282/14 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, pranë Gjykatës së Apelit.

Në aktgjykimin e saj PAKR. 157/15, të datës 28 maj 2015, Gjykata e Apelit ka gjetur se parashkrimi kishte skaduar dhe si të tillë e kishte ndryshuar aktgjykimin e apeluar P.-Kr. nr. 282/14 të Gjykatës Themelore të Prishtinës duke refuzuar aktakuzën PPS nr. 45/2012, të datës 19 maj 2015, të paraqitur kundër të pandehurve B. D. dhe H. T..

Më 24 qershor 2015, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR. 157/15, të datës 28 maj 2015.

2. Parashtrësit e palëve

Prokurori i shtetit i EULEX-it në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë pohon se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PAKR 157/15, i datës 28 maj 2015, përbën shkelje të ligjit penal në lidhje me nenin 90 paragrafët 5 dhe 6 dhe nenin 91 paragrafët 3, 5 dhe 6 të KPK-së, shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale në lidhje me nenin 370 paragrafin 11 të Kodit të Procedurës Penale² (KPP) si dhe shkale të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor në lidhje me nenin 3 paragrafin 2 të KPP-së.

Prokurori i shtetit i EULEX-it *inter alia* pretendon se Gjykata e Apelit thjeshtë është kufizuar në konstatimin e mospërputhjeve në versionet e gjuhëve të ndryshme të nenit 90 të KPK-së, duke iu referuar nenit 3 paragrafit 2 të KPP-së (i cili përcakton se në rast të ndryshimit të ligjit, zbatohet ligji më i favorshëm) duke përfunduar se zbatohet versioni i gjuhës më të favorshme, pa e bërë asnjë përpjekje që t'i rregulloj mospërputhjet për hir të koherencës së sistemit juridik.

Prokurori i shtetit i EULEX-it i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës që të deklarojë se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PAKR. 157/15, i datës 28 maj 2015, ka bërë shkelje të ligjit siç është cekur më lart.

Të pandehurve iu është dorëzuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë më 7 korrik 2015; sidoqoftë, nuk është paraqitur asnjë përgjigje brenda afatit kohor.

3. Kompetencat e kolegjit

Ligji Nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës (tani e tutje "Ligji Omnibus), i miratuar më 23 prill 2014 i cili ka hyrë në fuqi më 30 maj 2014 inter alia mbi ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (tani e tutje 'Ligji mbi kompetencat) rregullon kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it të cilat lidhen me kompetencat e gjykatës.

² Ligji Nr. 04/L-123, i publikuar në Gazetën Zyrtare të republikës së Kosovës Nr. 37, 28 dhjetor 2012

Kolegji e konsideron kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga Prokuroria si “rast në proces” sipas nenit 1.A të Ligjit omnibus . Prandaj, gjyqtarët e EULEX-it kanë kompetenca mbi lëndën.

4. Gjetjet

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit është e pranueshme, e paraqitur me kohë dhe e bazuar mirë.

Kolegji përcakton se aktgjykimi i kundërshtuar ka bërë shkelje të ligjit penal sa i përket nenit 90 paragrafit 5 dhe 6 dhe nenit 91 paragrafëve 3, 5 dhe 6 të KPK-së dhe shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sa i përket nenit 3 paragrafit 2 të KPP-së në dobi të të pandehurve.

Gjykata Supreme vëren se aktgjykimi i kundërshtuar ka vlerësuar drejt se ekzistojnë dallime në versionet në gjuhë të ndryshme të nenit 90 paragrafit 1 nën-paragrafit 6 të KPP-së. Përderisa versionet në gjuhën angleze dhe atë serbe periudhën e përcaktuar e zbatojnë si “vepër penale të dënueshme me **burgim deri në një vjet** ose me dënim me gjobë” versioni në gjuhën shqipe i dispozitës flet për “.....vepër penale të dënueshme me **burgim me më shumë se një vjet** ose me dënim me gjobë”.

Gjykata e Apelit , megjithatë bëri gabim me zbatimin e parimit të ‘*in dubio pro reo*’ të përcaktuar në nenin 3 paragrafin 2 të KPP-së në mospajtim në mes versioneve të gjuhëve të ndryshme, neni 3 paragrafi 2 i KPP-ës kërkon “...mëdyshjet lidhur me zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal.” Aktgjykimi i kundërshtuar gabimisht konstaton se kanë ekzistuar dyshimet e tilla pa e zbatuar asnjë metodë standarde të interpretimit, përveç interpretimit të fjalëpërfjalshëm lidhur me dispozitën në fjalë. Kjo e fundit është vetëm pikënisje. Interpretimi i fjalëpërfjalshëm i ligjit i shkruar në disa gjuhë të ndryshme, siç është rasti këtu, nuk mjafton sa herë që del ndonjë dallim në fjalëformim të versioneve të ndryshme gjuhësore. Në këtë rast duhet të përdoren metodat e tjera klasike të interpretimit, sikurse interpretimi sistematik dhe teleologjik me qëllim të eliminimit të konfuzionit. Metoda e parë do ta sqaronte kuptimin e dispozitës në kontekstin e normave të tjera brenda aktit të njëjtë ligjor dhe në veçanti të normave të cilat paraprijnë dhe pasojnë dispozitën në pyetje. E dyta do të sqaronte cila është arsyeja e ekzistimit të dispozitës në pyetje. Nëse formulimi i fjalëpërfjalshëm i dispozitës nuk del të jetë i arsyeshëm gjykata duhet të tentojë të gjejë një interpretim që ka kuptim.

Kolegji i Gjykatës Supreme gjatë përpjekjes për ta zgjidhur konfuzionin e krijuar nga versionet e ndryshme gjuhësore të dispozitës së njëjtë ka marrë parasysh çështjet në vijim: Gjatë përpjekjes për ta lexuar drejt dispozitën e nenit 90 paragrafit 1 nën-paragrafit 6 të KPK-së, gjykata është dashur të supozojë që ligjvënësi i ka menduar dispozitat për të rregulluar që parashkrimi të jetë logjik dhe i arsyeshëm (siç përmendet më lart – ligji duhet të ketë kuptim, edhe nëse fjalëformimi nuk ka kuptim). Periudha e përcaktuar për parashkrim zbrit hap pas hapi duke filluar nga nën-paragrafi 1 deri te nën-paragrafi 5 për veprat penale të dënueshme me sanksione me shkallë duke zbritur ashpërsinë. Në gjuhën angleze dhe atë serbe versionet e dispozitës e vazhdojnë këtë logjikë në nën-paragrafin 6 me periudhën e përcaktuar të parashkrimit më shkurt se ajo në nën-paragrafin 5 për veprat penale të dënueshme me sanksione më të buta (burgim deri në një vjet ose dënim me gjobë) se ato të përshkruara në nën-paragrafin paraprak (burgim me më shumë se një vjet). Në versionin në gjuhën shqipe,

megjithatë, përshkrimi i veprave penale dhe i sanksioneve në nën-paragrafin 6 përputhet me atë në nën-paragrafin 5, i cili përshkruan një periudhë më të shkurtër të parashkrimit. Është e qartë se nuk është as logjike e as e arsyeshme të përshkruhen dy periudha të ndryshme të afatit të parashkrimit për kategorinë e njëjtë të veprave penale. Rrjedhimisht, kolegji arrin në përfundim se kjo nuk ka mundur të jetë dëshira e ligjvënësit.

Me përdorimin e interpretimit sistematik duhet të merret parasysh se nën-paragrafi 6 nuk qëndron i vetëm dhe i izoluar dhe se duhet të lexohet i tërë neni 90 paragrafi 1 i KPK-së, siç është përshkruar më herët.

Në fund, metodat standarde të interpretimit sistematik dhe teleologjik detyrimisht qojnë kah një përfundim i vetëm, i cili është se versioni në gjuhën shqipe përmban një gabim ortografik kurse versionet identike në dy gjuhët e tjera janë të sakta, logjike dhe sistematikisht të qëndrueshme.

Si rezultat i këtyre shqyrtimeve kolegji vëren se çdo dykuptimësi lidhur me fjalëformimin e nenit 90 paragrafi 1 nën-paragrafi 6 të KPK-së duhet të zgjidhet duke zbatuar metodat standarde të interpretimit. Prandaj, nuk ka asnjë dyshim lidhur me implementimin e një dispozite të caktuar të ligjit penal, që do të linte hapësirë për zbatimin e parimit ‘*in dubio pro reo*’ të përcaktuar me nenin 3 paragrafi 2 të KPP-së.

Pasi është konstatuar se me aktgjykimin e kundërshtuar është bërë shkelje e ligjit në dobi të të pandehurve, Gjykata Supreme vëren se me nenin 438 paragrafi 2 të KPP-së ishte e kufizuar për konstatimin e shkeljes së ligjit pa ndërhyrë në vendimin e formës së prerë.

Duke u bazuar në këtë arsyetim kolegji vendos si në dispozitiv.

Përpiluar në gjuhën angleze, si gjuhë e autorizuar.

Anëtarët e kolegjit

Dariusz Sielicki
Gjyqtar i EULEX-it

Emine Mustafa
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Kryetare e kolegjit

Elka Filcheva-Ermenkova
Gjyqtare e EULEX-it

Procesmbajtës

Holger Engelmann
Zyrtar ligjor i EULEX-it

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
Pml.-Kzz. Nr. 150/2015
1 shtator 2015
Prishtinë